

klinika 24

REPORT TV

E shtunë 29 Mars 2025

NGA DOREADA MIO



REVISTA E SHËNDETIT

Këndi i autores

Rubrika ku sjellim përditësimet e fundit dhe këshillat e ekspertëve për të jetuar gjatë dhe shëndetshëm

EDITORIAL

Filmi "Adolescence" ka vetëm dy javë që transmetohet në platformën "Netflix" dhe ka një numër rekord shikuesish! E nëse ka diskutime për mënyrën e realizimit dhe cilësinë të gjithë janë dakort që ky film trajton tema të forta! Bullizmi, prindërimi, rrjetet sociale, teknologjia të gjitha këto ngrenë pikpyetje. Ku gabuam me prindërimin? Ç'sfida ka përpara shoqëria për këtë periudhë, adoleshencën... Historia e vrasjes së një vajze 13-vjeçare nga një bashkëmohatar është seria më e shikuar në botë në Netflix. Ajo tërheq dhe frikëson për shkak të së vërtetës së saj. Jamie, i dyshuari, luhet nga Owen Cooper, ndërsa Stephen Graham luan rolin e babait të tij. Historia hedh dritë mbi ndikimin gërryes të mediave sociale dhe influencësve mizogjinistë të disa djem adoleshentë. Megjithatë, krahas realitetit që përfshin, filmi ka krijuar shumë polemika, sepse përshkruan një adoleshencë të pasigurt, të trazuar dhe të ndërlikuar, duke sjellë tema që ndoshta janë të vështira për t'u diskutuar dhe duke sfiduar perceptimet tradicionale që mund të kemi për këtë periudhë të jetës.



“**Bullizmi, prindërimi, rrjetet sociale, teknologjia të gjitha këto ngrenë pikpyetje. Ku gabuam me prindërimin?**”



Edlira REHOVICA

Kirurgia e gjirit nga Spitali Hygeia



“**Nëse diagnostikoheni në kohë, kanceri i gjirit mund të kurohet**”

Eftuar në emisionin "Klinika 24" në Report TV, me moderatore Doreada Mio, ishte Edlira Rehovica, Kirurge senologe, në Spitalin Hygeia. Me avancimin e teknologjisë, në ditët e sotme ka më shumë shpresë për personat që vuajnë nga kanceri i gjirit, kjo falë dhe ndërgjegjësimit dhe mjeteve diagnostike që janë më shumë. "Fatkeqësisht kemi ulje të moshës së pacienteve që kanë probleme me kancerin e gjirit, përshëmbull sot brenda ditës pash tre paciente në moshë shumë të reja" tha mjekja

“**Fatkeqësisht kemi ulje të moshës së pacienteve që kanë probleme me kancerin e gjirit, përshëmbull sot brenda ditës pash tre paciente në moshë shumë të reja**”

në studio, duke shtuar se ky është një fenomen tashmë. Fuqia e mjekësve në këtë spital është fakti që mjekët punojnë në ekip,

pasi puna e tyre lidhet me stafin mbështetës që është shumë i rëndësishëm. Dr. Edlira ka gati 15 vite që ushtron këtë profesion dhe u shpreh shumë e kënaqur me të gjithë mbështetjen që merr nga Spitali Hygeia, për t'a bërë punën në mënyrë perfekte. Mjekja tha se ajo që bën është mision dhe e bën me shumë kënaqësi. Ajo tha se i pëlqen shumë psikiatria dhe nëse nuk do ishte bërë kirurge, do ishte bërë një psikiatre e mirë. Në fund të bisedës mjekja theksoi se të jesh mjek nuk rresht së mësuarit dhe studiuarit gjithmonë.

KIRUGJA EDLIRA REHOVICA KËSHILLON:



“Mesazhi i kirurges së gjirit për gratë dhe vajzat: Jeni të lumtura me ç ka keni, jeni falenderuese, rëndësia e shëndetit kuptohet kur dicka nuk shkon dhe të ndryshon gjithë këndveshtrimin për jetën! Nëse doni të jeni të shëndetëshme; Mos i neglizhoni kontrollet periodike!”

KIRUGJA EDLIRA REHOVICA KËSHILLON:



“‘Google problem i madh!’ Kirurgia e gjirit: Njerëzit po lexojnë informacione negative dhe të gabuara... Lexoni burime të besueshme dhe besojini mjekut...”

TERAPISTI ERMAL AZISLLARI KËSHILLON:



“Fëmijët janë kthyer në vende parkimi, 'Psikoterapisti: Prindërit nuk kanë më kohë... Duhet gjetur kohë për të qëndruar dhe komunikuar me fëmijët ...”

TERAPISTI ERMAL AZISLLARI KËSHILLON:



“Adoleshentët e heshur në fëmijëri mund të shpërthejnë ... Psikoterapisti zbulon çfarë ndodh nëse një fëmijë nuk i shpreh emocionet ...”

Ermal AZISLLARI

Terapist



“Prindërit duhet të jenë mirë vetë psikologjikisht së pari, e më pas të kujdesen për fëmijët”

I ftuar në emisionin “Klinika 24” në Report TV, me autore Doreada Mio, ishte i ftuar Ermal Azisllari, terapist me profesion, i cili foli për premirën e filmit “Adoleshanca” që ka marrë shumë shikime dhe reagime. Ai foli për prindërimin dhe për pyetjen që a mund të jemi shok me fëmijët tanë, si ndikon teknologjia në jetët tonë kohët e fundit. “Teknologjia është e pashmangshme dhe ka ritme që shpesh nuk e kapim dot” tha Ermali në studio, duke shtuar se adoleshenca vet është problematike dhe disi delikate,



por sot kemi një botë të pacensuruar në xhepin tonë, duke krijuar probleme sociale. Rritmi frenetik i shoqërisë moderne i


ka bërë gjërat shpesh mekanike. Nuk ka një formulë prindërimi, por prindërit bëjnë atë që mundën dhe aq sa kanë mundësi. Mungesa e modeleve brenda familjes sepse mungojnë gjatë ditës apo javës, gjenden jashtë apo në rrjetet sociale. Prindërit duhet të shohin dhe luhatjet e humorit tek fëmijët e tyre. Në fund të bisedës terapisti tha se edhe pse çdo rast është unik, kujdesi permanent për fëmijët nuk duhet të mungojë dhe se parimi është që së pari të rregullosh veten, e më pas të kujdesesh për fëmijën.



HYGEIA HOSPITAL TIRANA



Shërbimet Mjekësore



klinika 24

Prej **13** vjetësh

Emisioni mjekësor "Klinika 24" transmetohet çdo të shtunë në orën

20⁰⁰

në **REPORT TV**

si një dritare me informacione dhe këshilla të dobishme për shëndetin.



Misioni i këtij formati televiziv është edukimi, informimi dhe frymëzimi i teleshikuesve dhe ndjekësve për të jetuar shëndetshëm përmes krijimit të zakoneve të shëndetshme dhe informimit rreth zbulimeve e trajtimeve të reja në fushën e mjekësisë.

Në këtë mënyrë, **klinika 24**

Është një burim i rëndësishëm informacioni për të orientuar qytetarët drejt sfidës së mijëvjeçarit: të jetuarit gjatë dhe shëndetshëm